

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË MALIQ

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Maliq, me objekt: “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik financiar” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 9, datë 27.01.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 376/5, datë 27.01.2012, dërguar z. **Gëzim TOPÇIU**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1- Vleftha prej 1 184 mijë të “Aktivet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar” në zërin “studime dhe kërkime” sipas analizës të kalojë në “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuar” duke rritur vleftën e objekteve të përfunduara sipas zërave.

Në bilancin përfundimtar

2- Në urdhër pagesat e bankës duhet cilësuar, përshkruar, arsyeja e kryerjes së veprimit dhe speciminitetet e dokumentit shoqërues.

Vazhdimisht

3- Në prokurimet me vlera të vogla për punimet që duhet të kryhen për të llogaritur nevojat materiale që nevojiten, duhet të ketë preventiva dhe mbi këtë bazë të dalë urdhri i prokurimit.

Vazhdimisht

4- Urdhër shpenzimet duhet të shoqërohen me preventiv ose dokument tjetër që të tregojë vendvendosjen, llojin, apo specifikimet teknike të mallit që do të blihet.

Vazhdimisht

5- Duhet të merren masa të minimizohen veprimet me arkën dhe të kryhen nëpërmjet bankës. Në periudha të caktuara të mbahen procesverbale për kontrollin e gjendjes së arkës dhe gjendja fizike nuk duhet të jetë mbi kufirin limit të arkës.

Vazhdimisht

6- Planifikimi i Taksës mbi biznesin e vogël të kryhet duke u mbështetur te realizimet e viteve të mëparshme dhe mbi bazën e studimeve të mirëfillta për rritjen demografike në juridiksionin e bashkisë duke ndjekur politikën dhe strategjinë e licencimit të rrjetit të tregtisë duke u bazuar në mundësitë reale që ka kjo bashki.

Vazhdimisht

7- Në dosjet e arkivuara të prokurimeve duhet të jenë projektet dhe preventivat e objektit, të cilat janë pjesë e dokumenteve të tenderit. Gjithashtu pjesë e dosjes të jenë edhe dokumentet me analizat për llogaritjen e kufirit monetar, çmimet për njësi të përdorura dhe të dhënat statistikore të marra për bazë në përcaktimin e tyre sipas nenin 28 të ligjit nr. 9643, datë 21.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 12 pika, e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” kreu II.

Vazhdimisht

8- Nga drejtoria e financës dhe zyra e taksave për debitorët:

- Tu dërgohet Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në bankat, vendosjen e barrëve siguroese, vendosjen e sanksioneve apo gjoba për mos pagimin e detyrimeve në afat sipas listës të subjekteve, regjistrimin me detyrim kur subjekti nuk është regjistruar në

afat, gjobitjen në masën 10.000 lekë, për mos deklarimin në afat dhe mos mbajtjen e saktë të librave, ndërhyrje me forcë të policisë bashkiake për vjeljen e debitorëve.

- Të bashkëpunohet me Degën e Shfrytëzimit të Automjeteve në lidhje me inventarizimin e plotë të mjeteve në pronësi të qytetarëve sipas llojit të tyre, tonazhit, etj dhe të hartohen aktrakordimet për listat emërore e personave që kanë paguar ose jo këtë taksë.

-Sektori i financës në fund të vitit të pasqyrojë në kontabilitet listat e debitorëve për detyrimet fiskale,

Vazhdimisht

9- I rekomandojmë Bashkisë që para hartimit dhe nënshkrimit të kontratave administrative (neni 151 i Kodit të Procedurës Administrative) të mund të marrë këshillimin e Avokaturës së Shtetit duke lidhur marrëveshje me të sipas ligjit nr. 10 018, dt. 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” neni 15, pika 3 dhe VKM nr. 392, dt. 8.4.2009, kreu VI, neni 26/1, neni 27/2.

Vazhdimisht

B-MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

-Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej **66 461 lekë**, nga personat e subjektet e mëposhtëm për mos arkëtimin e vleftës **1 për qind të vlerës së investimit** sipas preventivit të objektit e ndarë si më poshtë:

1- [REDAKTUAR] për objektin “rikonstruksion banese + shtesë kati” për 33 072 lekë.

2- [REDAKTUAR] për objektin “bar + sallon bastesh” për 33 389 lekë.

Menjëherë

Në kundërshtim me nenin 51 te ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”,

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Bexhet Zeqiri, Vasillaq Peci dhe Qemal Meta. Më tej u shqyrtua nga Krye Audituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT